



AGJENCIA KADASTRALE E
KOSOVËS



PROCEDURAT STANDARDE TË OPERIMIT NË SISTEMIN E REGJISTRIT PËR TË DREJTAT NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR ODËN E PËRMBARUESVE PRIVATË TË KOSOVËS

I. HYRJJE

Ky dokument paraqet Procedurën Standarde të Operimit që përmbaruesit, përmes Odës së Përmbaruesve, të kenë qasje në Sistemin e Regjistrit për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme. Ky dokument është pjesë përbërëse e Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Odës së Përmbaruesve Privat të Kosovës.

II. QËLLIMI

Qëllimi i këtij dokumenti është paraqitja specifike e procedurave standarde se si përmbaruesit mund të kyçen dhe ta përdorin sistemin në fjalë si dhe mënyra e realizimit të pagesave.

III. FUSHËVEPRIMI

Fushëveprimi i këtij dokumenti mbulon vetëm pjesën e sistemit për të cilën përmbaruesve u ofrohet qasje.

IV. PËRKUFIZIME

Për qëllime të kuptimit dhe interpretimit më të lehtë të veprimeve të caktuara, fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë dokument kanë kuptimet që janë ofruar në Memorandumin në fjalë. Nëse ndërkohë paraqitet nevoja për interpretim të ndonjë fjale, shprehje, ose veprimi të caktuar, e njëjta do të interpretohet sipas praktikave standarde të Teknologjisë Informative.

V. PËRGJEGJËSIA

1. Oda e Përmbaruesve ka të drejtën që në emër të secilit përmbarues që është anëtar i Odës të ia paraqes AKK-së të gjitha ndryshimet në listën e përmbaruesve – anëtarëve të Odës, duke përfshirë lejin apo ndërprerjen e qasjes për secilin përmbarues që është anëtarësuar në Odë, dhe Oda e informon AKK-në për ndryshimet në listën e përmbaruesve-anëtarë të Odës.
2. Oda, sipas kërkesës së AKK-së ose me iniciativën e saj, mund t'ia kufizojë pjesërisht ose blloktojë tërësisht qasjen përmbaruesit që konsiderohet se i ka tejkaluar, shkelur ose ka kryer ndonjë veprim që e dëmton sistemin e AKK-së ose reputacionin e Odës si dhe në rast të mos përbushjes së obligimeve të pagesës.

3. Secili përmbarues është përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e saj/tij gjatë përdorimit të këtij sistemi.
4. Dëmet e shkaktuara nga përmbaruesi gjatë përdorimit të këtij sistemi, përveç përgjegjësisë disiplinore dhe administrative, nuk e përjashtojnë edhe përgjegjësinë materiale, dhe dëmet eventuale në asnjë mënyrë nuk konsiderohen si përgjegjësi për Odën si institucion.

VI. PROCEDURA STANDARDE

1. Në zyrën e çdo përmbaruesi duhet të ketë lidhje interneti.
2. Në shfletues të internetit (browser) duhet të shkruhet faqja e adresës për <https://siktk-online.rks-gov.net/online> dhe nga këtu duke përdorur kredencialet e ofruara për secilin përmbarues bëhet kyçja në sistem.
3. Kërkesa për ofrimin e qasjes për shfrytëzuesit e rinj, çkyçjen nga sistemi të shfrytëzuesve ekzistues, kufizimin e qasjes për shfrytëzuesit ekzistues, ose resetim të fjalëkalimit, duhet të dërgohet nga Oda tek AKK-ja.

VII. SIGURIA DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE

1. AKK-ja dhe përmbaruesi kujdesen së bashku për sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave të sistemit, ashtu si edhe për privatësinë e të dhënave të subjekteve të regjistruara në sistem.
2. Keqpërdorimi ose përdorimi i panevojshëm i të dhënave të sistemit, i nënshtrohet legjislacionit të Republikës së Kosovës, si dhe kufizimeve të këtij dokumenti.

VIII. FATURIMI DHE PAGESA E PRODUKTEVE

1. Tarifat për shërbimin e ofruar përmes web shërbimeve janë të përcaktuara me udhëzim administrativ.
2. Faturimi i produkteve të marra do të bëhet në fund të çdo muaji kalendarik.
3. Fatura dhe raporti do t'i dërgohet Odës së Përmbaruesve përmes email-it, ose do të tërhiqet nga zyrtari i autorizuar prej tij,
4. Pagesa duhet të kryhet në afatin prej njëzet (20) ditësh të muajit vijues.
5. Nëse nuk bëhet pagesa e faturës sipas afatit të përcaktuar, përmbaruesit do t'i ndërpritet qasja dhe lënda do të procedohet në përmbarim

Për Odën e Përmbaruesve të Kosovës

Kryetari i Odës
Arben Gashi

Datë:
16.10.2020



Për Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Kryeshefi ekzekutiv
Avni Ahmeti

Datë:
16.10.2020

